

# Afloderm



**Principi aktiv-** Alclometasone 0.5mg/1g

**Forma:** Pomadë

**Sasia:** 20 gr

## **Farmakokinetika:**

Në lëkurën e pa dëmtuar absorbimi sistemik i alclometazonit nuk kalon 3%. Dëmtimi i integritetit të lëkurës çon në një përthithje më të madhe të tij. Biotransformimi i tij më i madh bëhet në hepar në formën e metaboliteve të cilët eliminohen kryesisht me anë të urinës.

## **Farmakodinamika:**

Alclometazoni ka veti antiinflamatore, imunosupresive dhe antiproliferative. Ul permeabilitetin dhe ndryshon ndërtimin membranor, redukton migrimin macrofageal dhe të limfociteve në qendër të inflamacionit duke ngadalësuar të gjitha fazat e inflamacionit, duke bllokuar lëshimin e qelizave yndyrore të ndjeshme dhe lëshimin e histaminës së bazofileve si dhe substancave të tjera aktive. Ul inflamacionin në inde dhe eliminon dhimbjet dhe mund të përdoret në lëkurë sensitive dhe në fytyrë.

## **Përdorimi :**

1-2 lyerje në ditë sipas përshkrimit të mjekut

## **Indikacionet :**

Dermatiti atopik, psoriasis, urtikarie, sëmundje alergjike të lëkurës, në rastet e dermatozave në zonat e ndjeshme të lëkurës si fytyra.

## **Shtatzëni dhe laktacion**

Nuk rekomandohet të përdoret në shtatzëni dhe në lëkurën e gjoksit gjatë laktacionit.

## **Kundër indikimet**

Hipersensitiviteti, tuberkulozi i lëkurës, dermatitis perioral, rosacea, komplikimet e vaksinimit

**Efektet anësore:**

Efektet anësore janë të rralla dhe përfshijnë djegie, kruarje, skuqje, iritim dhe tharje të lëkurës. Akoma më rrallë mund të shfaqen folikuliti, atrofia e lëkurës dhe dermatitis i kontaktit sekondar si pasojë e infeksioneve të lëkurës.